



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKIAK
GRAMSH**

Nr. 287/3 Prot.

Gramsh, më 05.02.2026

V E N D I M

Nr. 11 , date 30/01/2026

MBI

**MIRATIMIN E LISTËS SË KULLOTAVE E LIVADHEVE
TË GATËSHME PËR KULLOTJE E KOSITJE SI DHE TË KONTRATËS TIP.**

Këshilli i Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 30.01.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 3 gërma “ç”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/ b, neni 23/4, si dhe neni 54 gërma “k” e tij, të ligjit nr.111, datë 31.10.2024, për disa ndryshime të ligjit 9693, dt.19.03.2007 “Për Fondin Kullosor” i ndryshuar, nenit 15 (përdorimi për kullotje), pikat 1,2,3,4,5 dhe 6, nenit 17 (përdorimi i sipërfaqes dhe tokës), të VKM nr.467, datë 31.07.2025 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”, të VKM nr.684, datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.02, datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, kreu i II-të, pika 1,2 dhe 12:

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e kullotave dhe livadheve të gatëshme për kullotje e kositje, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Të miratojë kontratën tip për dhënien me qera të kullotave e livadheve, bashkëngjitur këtij vendimi.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetarin e Bashkisë dhe Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit së Konsumatorit pranë Bashkisë Gramsh.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI

